



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.51/2017

Prishtinë, më 22 mars 2017

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, Nenad Rashiq, Mexhide Mjaku-Topalli, Mytaher Haskuka, Teuta Haxhiu, Etem Arifi dhe Shukrije Bytyçi.

Munguan: Salihe Mustafa dhe Kujtim Paçaku.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinator i Komisionit dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Hilmi Jashari-Avokat i Popullit, Shqipe Paqarada-IAP, Xheladin Hoxha-drejtor i Departamentit Ligjor - Kuvendi i Kosovës, Fehmi Pireva, zyrtar ndërlidhës me Institucione të Pavarura - Kuvendi i Kosovës, Teuta Prekazi-UNMIK, Visar Bivolaku-EUO/EUSR, Sanije Berisha-OSBE, Nesrete Kumnova-OJQ “Thirrjet e Nenave”, Haki Kasumi – OJQ, Shoqata e të Pagjeturve - Prishtinë, Prenk Gjetaj, ZKM KQPZH, Kushtrim Gara-ZKM –KQPZH, Bajram Qerkini-KKAFZHK, Fatlinda Gashi-KDI, Jeta Rafuna-GPLDK, Albulena Nura-RTV21, Mergim Hoti-Praktikant, Mejreme Tahirukaj-Radio Kosova, Beadin Sylakosova Press, Valmira Saraqi-KTV, Edona Kurteshi-Koha Ditore.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Anëtarët e Komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e Komisionit.

Andaj, Komisioni i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme;
2. Shqyrtimi i Vendimit të Avokatit të Popullit për propozimin e kandidateve për zgjedhjen e 5 zëvendësve të Avokatit të Popullit;

3. Diskutimi lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-023 për Persona të Zhdukur: Të ftuar Shoqatat e familjareve të personave të zhdukur;
4. Shqyrtimi i Peticioneve;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme

Kryetarja konstatoi se procesverbalet, e mbledhjeve të mbajtura më 1 dhe 6 mars 2017, u miratuan pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Vendimit të Avokatit të Popullit për propozimin e kandidatëve për zgjedhjen e 5 zëvendësve të Avokatit të Popullit

Kryetarja tha se Avokati i Popullit ka sjellë Vendimin lidhur me propozimin e kandidatëve për zgjedhjen e 5 zëvendësve të Avokatit të Popullit, me mandat 3 vjeçar, sipas renditjes e cila është paraqitur në propozim si vijon: Albert Avdiu, Aleksandra Dimitrijeviq, Majlindë Sinani-Lulaj, Veton Vula, Murlan Prizreni, Mehdi Geci, Basri Berisha, Baki Sfishta, Afërdita Rexha dhe Naile Alaj. Ajo tha se arsyetimin për këtë propozim do ta paraqesë Avokati i Popullit.

Hilmi Jashari: Më 29 nëntor 2016, është hapur konkursi ne pajtim me kriteret që i parasheh ligji dhe më 19 dhjetor është mbyllur konkursi dhe po atë ditë kemi formuar komisionin rekrutues. Më 30 janar 2017 është bërë përpilimi i listës së ngushtë të cilët i kanë plotësuar kushtet formale dhe më 1 shkurt është bërë njoftimi i kandidatëve për intervistim. Intervistat janë zhvilluar në datat 7, 8, 9 dhe 10 shkurt 2017, dhe janë paraqitur gjithsejtë 48 kandidatë, nga ta 34 shqiptarë dhe 14 të komunitetit serb. Sipas gjinisë kanë qenë 20 femra dhe 28 meshkuj, prej tyre 42 janë ftuar në intervistë 33 shqiptarë dhe 9 serbë. Intervistës iu kanë nënshtruar 38 kandidatë, sipas përkatësisë etnike 31 shqiptarë dhe 7 serbë. Me 22 shkurt është bërë raporti i komisionit për rekrutim dhe intervistim dhe më 10 mars kemi dërguar vendimin së bashku me propozimin e listës dhe gjithashtu raportin përcjellës për vlerësimet në Kuvendin e Kosovës.

Nenad Rashiq tha se është e çuditshme se ka vetëm një kandidat serb në listë. Ai u interesua të dijë se si është menduar të përzgjidhet zëvendësavokati nga komunitete jo shumicë, kur thuhet se për një pozitë Zëvendësavokat i Popullit nga Komuniteti jo shumicë dhe i gjinisë tjetër nga ai i Avokatit të Popullit, votimi bëhet i ndarë, ky propozim nuk është në përputhje me rregullat dhe kemi të bëjmë me shkelje të ligjit dhe rregullores.

Hilmi Jashari tha se e ka të njëjtin shqetësim me parafolësin, sepse edhe interesi i ynë ka qenë që të kemi sa më shumë kandidatë të pakicave në listë. Ligji për Avokatin e Popullit, ka një dispozitë që thotë se gjatë procesit të zgjedhjes në Kuvend, së paku një nga zëvendësit duhet të jetë nga pakicat kombëtare. Ndërsa dispozita që cakton se për secilin kandidatë duhet të jenë të propozuar së paku dy kandidatë, aty nuk ceket se i cilës përfaqësi etnike duhet të jetë. Kandidati serb, që i bie i dyti nga komunitetet, është i renditur në listë si kandidati i 35 për nga poenët, dhe nuk do të ketë kuptim nëse një kandidat i cili ndodhet në listë në vendin e 35 sipas vlerësimeve të këtij komisioni të mund të renditet në propozimin e 10 kandidatëve të parë, sipas poenave. Nuk besoj se kjo do të paraqet problem në procedura sepse është në kompetencë të plotë të deputetëve të Kuvendit për të votuar apo jo kandidatin i cili është nga pakicat kombëtare, dhe nëse nuk i merr votat atëherë i hyhet procesit për të rishpall eventualisht për pozitën për këtë kandidatë.

Xheladin Hoxha, nga administrata e Kuvendit, dha sqarime se si të procedohet në Kuvend për zgjedhjen e zëvendësve të Avokatit të Popullit.

Nenad Rashiq tha se propozimi kështu si është me një kandidatë nga komuniteti jo shumicë është i mangët dhe në këtë formë nuk bën të procedohet për votim në Kuvend, sepse nuk janë plotësuar as kriteret ligjore, e as të rregullores të cilën e ka votuar Kuvendi, ose duhet të shkohet lista me dy kandidatë të komuniteteve jo shumicë ose të shpallet konkurs për pozitën e komunitetit jo shumicë, zgjidhje tjetër nuk shoh dhe nëse veprohet ndryshe ka shkelje ligjore dhe të procedurave.

Hilmi Jashari tha se nëse nga këtu del se duhet të ndryshohet apo plotësohet lista, unë nuk mund të shpjegojë ndryshe veç se si ndërhyrje në pavarësinë e Institucionit të Avokatit të Popullit.

Mytaher Haskua tha se në listë janë 10 kandidatë dhe kemi se paku dy kandidatë për një pozitë, gjatë procesit të votimit duhet të shpjegohet se njëri nga zëvendësit duhet të jetë nga komuniteti jo shumicë dhe një pozitë duhet të jetë nga gjinia tjetër e pozitës së Avokatit të Popullit. Pra, të procedohet kështu dhe nëse kandidati i minoriteteve nuk arrin t' i merr votat e duhura atëherë shkohet me shpallje të konkursit, nuk është në rregull të plotësohet lista me kandidatin që është renditur i 35 në listë.

Teuta Haxhiu tha se nëse shkohet në këtë mënyrë kandidatja e komunitetit në listë, prej sot është zëvendëse, pavarësisht se si votohet në seancë. Problemi është edhe te tri kandidatet femra të cilat garojnë dhe do të dalë problem në seancë. Andaj si ta gjejmë një rrugë më të shkurtër, sepse nëse shkohet në seancë kështu mund të kthehen dhe nuk po bëjmë zgjidhje.

Mexhide Mjaku-Topalli tha se në Vendimin e Avokatit të Popullit, është e sqaruar shumë mirë, ku thuhet se të paktën njëri nga zëvendësit duhet të jetë nga komunitete jo shumicë. Ne duhet t' i referohemi ligjit saktë duke sqaruar edhe Kuvendin që duhet të jetë një zëvendës nga komuniteti një nga gjinia e kundërt e Avokatit të Popullit.

Lirije Kajtazi tha se pas këtyre dilemave që u shfaqen në komision, a ka Avokati ndonjë zgjidhje alternative brenda kornizave ligjore që është e lejuar?

Hilmi Jashari tha se edhe votimi për një kandidatë apo mos votimi është votim, dhe duhet të sqarohet gjatë votimit që njëri nga zëvendësit duhet të jetë nga pakicat dhe një nga gjinia tjetër e Pozitës së Avokatit të Popullit, zgjidhja teknike veç është e qasshme, dhe mos të krijojmë situata që munden mu trajtua edhe si ndërhyrje dhe me kthye procesin mbrapa.

Nenad Rashiq tha se i duhet ende kohe për sqarime dhe kërkoj që mos të vendoset sot, por të shqyrtohet edhe njëherë në mbledhjen e radhës.

Kryetarja konstatoi se me kërkesën e deputetit Nenad Rashiq, kjo pikë shtyhet për mbledhjen e radhës.

Ajo kërkoi nga Departamenti Ligjor i Kuvendit të Kosovës, që të sjellë një këshillë juridike se si të procedohet ky propozim i Avokatit të Popullit.

3. Diskutimi lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-023 për Persona të Zhdukur: të ftuar, shoqatat e familjareve të personave të zhdukur

Kryetarja tha se së bashku me shoqatat e familjarëve të zhdukur kemi identifikuar nevojën e ndryshim- plotësimit të ligjit për personat e zhdukur dhe e kemi parë të nevojshme që këtë çështje ta diskutojmë edhe me ju.

Prenk Gjetaj tha se prej momentit të miratimit të këtij ligji ka qenë kërkesë e familjarëve të personave të zhdukur që ky ligj të ndryshohet dhe të plotësohet. Ai tha se çështjet që duhet të rregullohen kanë të bëjnë me: përfshirjen e datës për persona të pagjetur, statusi i të pagjeturit, të përfshihen edhe ata nga vitet 90-ta, sepse në ato vite ka qenë luftë e pashpallur, një çështje mos të trajtohet nga dy institucione, dhe me dy ligje si është ligji për mjekësinë ligjore edhe ligji për persona të zhdukur, sepse pastaj po shfaqen kundërthënie mes ligjeve.

Haki Kasumi tha se kategorisë më të goditur që 17 vjet i shkelen të drejtat më elementare më njerëzore. Të ketë aq pak përkujdesje nga Institucionet tona është e papranueshme. Kemi disa vërejtje në emër të familjarëve për ligjin, ky ligj përveç emrit që e ka më së paku merret me personat e zhdukur. Vërejtja e parë e familjarëve është përkufizimi i kohës që përfshin ky ligj, ose të shtohet emërtimi i ligjit persona të zhdukur para, gjatë dhe pas luftës ky është një propozim, në momentin që personi i zhdukur identifikohet automatikisht trajtohet dhe si viktime civile, e vërteta faktike është krejt diçka tjetër. Kërkojmë të shtohet interesi i shtetit ndaj familjarëve të personave të zhdukur dhe në veçanti ndaj personave të pagjetur, dhe të sigurohet pavarësi për komisionin qeveritar për persona të zhdukur, sepse ky komision i ka duart e lidhura sidomos sa i përket buxhetit.

Nysrete Kumnova tha se edhe njerëzit na mungojnë edhe ligji na dëmton drejtpërdrejt, kjo është shkelje e të drejtave të njeriut. Familjet që kanë familjarë të zhdukur përveç ankthit po përballën edhe me kushte të vështira ekonomike, kërkoj që të ju plotësohen kushtet e jetesës dhe zbardhja e fatit të personave të pagjetur. Ajo tha se kërkesat i ka paraqitur edhe me shkrim anëtareve të komisionit.

Bajram Qerkini tha se ky ligj qysh prej aprovimit ka qenë ligj diskriminues për neve. Premtime janë bërë shumë, por në fakt ndryshime s' ka fare. Për me ndryshuar këtë ligj duhet të punohet shumë, qysh prej emrit të pagjetur e deri në fund. Nuk është bërë asgjë për këtë kategori, për familjarët, fëmijët e personave të zhdukur nuk i kanë të drejtat që i kanë kategoritë e tjera të dala nga lufta. Ai theksoi se i kemi 8 kërkesa, që ju i keni para vetes.

Lirije Kajtazi theksoi se sot kemi vendos t' ju dëgjojmë, pavarësisht që disa çështje që u përmendën këtu, kalojnë përtej ligjit për të zhdukur. Këtu flitet edhe për ligjin për skemat sociale, ligjin për veteranët, ligje të tjera, që kjo kalon edhe kompetencat e komisionit tonë. Ne, pasi i dëgjuam këto paraqitje, duhet të formojmë grupin punues për t'i shqyrtuar në detaje këto kërkesa, por gjithsesi duhet ta dëgjojmë edhe Ministrin e MPMS-së, sepse ai përgjigjet edhe për ligjet që kanë të bëjnë me dikasterin që ai udhëheq.

Mexhide Mjaku-Topalli në këtë komision bashkërisht punojmë për interesat tuaja, të gjitha këto shqetësime tuaja do t'i shqyrtojmë pastaj. Ajo tha se çështjen e skemave pensionale e kishte ngritur edhe në Kuvend, në seancën e fundit.

Ligji për pensionet e thotë se nuk merren dy pensione në të njëjtën kohë, por nuk guxon të llogaritet pension çështja e marrjes së pensionit për fëmijën e zhdukur, për familjarët e të rënit dëshmorë.

Për këtë çështje. si dhe të tjera, kam kërkuar që të ftojme në Komisionin Funkcional, ministrin e MPMS-së, dhe besojmë se do t'i trajtojmë shumë shpejt edhe shqetësimet e ngritura në këtë mbledhje.

Teuta Haxhiu tha se gjatë rishqyrtimit të buxhetit ka iniciuar ndarjen e mjeteve në vlerë prej 300 mijë euro për kompleksin memorial në Meje.

Kërkesa për ta ndryshuar Ligjin për të Zhdukurit, është e kamotshme. Kërkesa bazë është që termi viktimë civile është i papranueshëm, nga se secili prej neve, kur shkojmë nëpër akademi përkujtimore asnjëherë nuk themi të nderuar familjarë të viktimave civile, por të nderuar familjarë të martirëve, që në fakt në ligj nuk e kemi.

Vullneti për të ndryshuar këtë ligj ekziston dhe e kemi marrë këtë nismë para se të shënohet data e 27 Prillit, dhe pjesë e grupit të punës për ndryshimin e këtij ligji do të jeni edhe ju si familjarë të personave të pagjetur.

Nenad Rashiq pyeti se sa është numri i familjeve që janë në kategorinë e familjeve që kanë familjarë të zhdukur?

Prenk Gjetaj për numrin e familjeve nuk mund të them tash, por tha se aktualisht janë 1660 persona të zhdukur, sa përfitojnë skema pensionale gjithashtu nuk kemi njohuri. Këtë rregullojeni me ligj dhe ministria patjetër se duhet ta zbatojë ligjin. Duhet të bëhet një memorial qendror në Prishtinë, i kemi artefaktet që nuk po kemi ku me i vendosur, ato janë nën vullnetin e mëshirës së Mjekësisë Ligjore që deri tani kanë qenë të vendosura aty.

Bajram Qerkini tha se 1626 personave – familjarë të të pagjeturve, iu është ndalë kompensimi, pa asnjë informatë.

Neserte Kumnova tha se edhe ato familje që i kanë të dy prindërit e zhdukur nuk marrin asnjë kompensim.

Lirije Kajtazi, tha se në grupin punues propozoj të jetë një anëtar nga Komisioni Qeveritar dhe një nga shoqatat, por besoj që emrat na i dërgoni në ndërkohë, ndërsa nga Komisioni në përbërje të plotë do të jetë pjesë e grupit punues.

4. Shqyrtimi i Peticioneve

Kryetarja tha se kemi për shqyrtim kërkesën e një qytetari, i cili është i pranishëm në këtë mbledhje, dhe do ta prezantojë lëndën më në detaje se për çka bëhet fjalë.

Rrahim Bajrami tha se lënda e tij për 14 vjet është në gjykatë, në vitin 2009, e kanë shpallur të vdekur, 4 herë ka qenë në gjykatë dhe asnjëherë nuk është mbajtur seanca e plotë.

Teuta Haxhiu pyeti se kush e ka shpallur të vdekur?

Rrahim Bajrami tha se të vdekur e kanë shpallur dy avokatë dhe një gjykatës. Tha se padinë e ka bërë përmes organeve kompetente, në vitin 2009, dhe prej atëherë gjykata ende nuk e ka përfunduar punën e saj.

Ai prezantoi para Komisionit shumë dokumente që lidhen me këtë rast, siç është edhe raporti i Avokatit të Popullit për rastin në fjalë.

Mytaher Haskuka pyeti se çka është çështja e gjykatës pse ju kanë shpallur të vdekur?

Rrahim Bajrami tha se çështja është për një kontest pronësor në Çagllavicë.

Lirije Kajtazi tha se e kam parë lëndën, meqë lënda është zvarritur nëpër gjykata Këshilli Gjyqësor ka për obligim disiplinën e gjykatave dhe kërkon llogari nga gjykatat, zvarritjen e ka konstatuar edhe Avokati i Popullit, dhe zërit të tyre i bashka ngjitemi edhe ne, si komision, në mënyrë që të arrihet drejtësia për këtë rast.

Teuta Haxhiu, tha se ajo ka iniciuar një debat parlamentar për mos zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, dhe personalisht rastin në fjalë do ta diskutojë edhe në atë debat.

Mexhide Mjaku-Topalli, pyeti të pranishmin lidhur me blerjen e asaj prone, si dhe a ka ndërtime në atë pronë.

Rrahim Bajrami tha se pronën e ka blerë në vitin 1970, në atë pronë janë ndërtuar tri shtëpi dhe bëhet fjalë për 60-ari tokë. Shkalla e parë e Gjykatës, i kanë thënë se toka i takon atij dhe janë dokumentet, në shkallën e dytë janë ankuar dhe aty janë bërë ato padrejtësitë, theksoi ai.

Lirije Kajtazi, konstatoi se Komisioni Funkisional do t'i drejtohet përmes një shkrese, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë, për sqarime rreth rastit në fjalë.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 15:45.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetarja e Komisionit,

Lirije KAJTAZI